



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.14, datë 26.02.2026

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6%
PËR MUAJIN JANAR 2026”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26.02.2026, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të ligjit nr.57/2019 “Për asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë” VKM nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike si dhe Udhëzimit nr.3, datë 17.02.2017 i ndryshuar, VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e cmimit të energjisë elektrike. Udhëzimi nr.10, datë 26.09.2006, si dhe VKM nr.8, datë 14.05.2015 “Për kompesimin e fatures së energjisë elektrike për heqjen e fashës deri në 300 KËH si dhe bazur në kriteret e VKB nr.6, datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”.
Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe PAK-së:

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin **Janar 2026** përfitojnë **32 familje** me një fond prej **102, 566 lekë** nga këto **6 familje** përfitojnë kompesimin e energjisë elektrike me fond **7,228 lekë**.
2. Fondi gjithsej i shpenzuar për muajin Janar 2026 është **110,294 lekë**.
3. Familjet përfituese sipas listës bashkëlidhur.
4. Nivelet e pagesës të jenë bazuar në V.K.M nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, si dhe Udhëzimit nr.3, datë 17.02.2017 i ndryshuar.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

